



BASHKIA
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TIRANË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME Nr. 2 E PUNËTORËVE TË QYTETIT

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Datë 19/10/2018

Nga: Drejtoria e Përgjithshme Nr. 2 e Punëtorëve të Qytetit, Tiranë.

Drejtuar: Shoqërisë “INSIG” sh.a, me NUIS L71325019D dhe me adresë: Rruga “Jul Variboba”, Nr. 21, Tiranë.

Procedura e prokurimit: “Kërkesë për Propozim”.

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-87210-09-25-2018.

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “Shpenzime për siguracionin e mjeteve të transportit”, afati: 12 (dymbëdhjetë) muaj nga nënshkrimi i kontratës.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët oferta ekonomikisht më e favorshme

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike Nr. 39, Date 01.10.2018.

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara si më poshtë:

1. **Operatori Ekonomik “INSIG” sh.a me NUIS L71325019D me ofertë 1.499.452** (një milion e katërqindë e nëntëdhjetë e nëntë mijë e katërqindë e pesëdhjetë e dy) **Leke pa TVSH.**
2. **Operatori Ekonomik “Intersig Vienna Insurance Group” sh.a me NUIS K12201002T me ofertë 1.488.133** (një milion e katërqindë e tetëdhjetë e tetë mijë e njëqindë e tridhjetë e tre) **Leke pa TVSH.**

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

“Intersig Vienna Insurance Group” sh.a me NUIS K12201002T

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Nuk plotëson pikën 2.3.1 të kapacitetit teknik ku është parashikuar “Shërbime të ngjashme të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e zhvillimit të tenderit, të aktivitetit të operatorit, në vlerën prej jo më pak se 40% e fondit limit të vënë në dispozicion përkatësisht: **610.726** (gjashtëqind e dhjetë mijë e shtatëqind e njëzetë e gjashtë) lekë pa TVSH”. Mbështetur në parashikimin e mësipërm dhe në “Rekomandimin mbi hartimin e kriterëve për kualifikim në dokumentet e tenderit të procedurave të prokurimit public” të Agjencisë së Prokurimit Publik me Nr. 3341/1

Prot, datë 20.03.2018, 3 vitet e fundit të aktivitetit të OE do të llogariten nga data e zhvillimit të tenderit (08.10.2015 - 08.10.2018). Operatori ekonomik “Intersig Vienna Insurance Group” sh.a ka paraqitur polica për sigurimin e detyrueshëm të lëshuara në muajin janar 2015, jashtë periudhës të përcaktuar më lart.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Shoqërinë “**INSIG**” sh.a me **NUIS L71325019D** me adrese: Rruga “Jul Variboba”, Nr. 21, Tiranë, se oferta e paraqitur me një vlerë të përgjithshme prej: **1.499.452** (një milion e katërqindë e nëntëdhjetë e nëntë mijë e katërqindë e pesëdhjetë e dy) Lekë pa TVSH, **është identifikuar si ofertë e suksesshme.**

Rrjedhimisht, jeni të lutur të paraqisni pranë **Drejtorisë së Përgjithshme Nr. 2 të Punëtorëve të Qytetit, Rruga 5 Maji**, sigurimin e kontratës siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 30 (tridhjetë) ditëve që nga dita e marrjes së këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i klasifikimit është bërë në datë 11.10.2018.

Ankesa: Nuk ka.

